

PROFIL BIOGRAFIK

Shën Maria Mantovani bija e parë ndër katër fëmijët lindi në Castelletto di Brenzone (VR) më 12 nëntor 1862 nga Giovanni Battista Mantovani dhe Prudenza Zamperini. U pagëzua në të nesërmen më 13 nëntor. Mori sakramentin e Krezmimit më 12 tetor 1870 dhe Kungimin e Parë më 04 nëntor 1874.

Ndoqi me rezultate të larta shkollën fillore, por nuk arriti të vazhdojë studimet për shkak të varfërisë së familjes. Kulturës shkollore të dobët, i zuri vendin dhuratat e bukura të inteligjencës, vullnetit dhe e arsyes së shëndoshë. Që në moshë të vogël ishte e dhënë pas lutjes dhe gjithçka që i përkiste Hyjit. Themel i kësaj ndjeshmërie të thellë fetare dhe të krishterë si dhe i gjithë pasurisë hyjnore, destinuar për t'u zhvilluar dhe për të rrezatuar dritë të gjallë, ishte dëshmia e prindërve dhe e familjarëve, njerëz të thjeshtë, punëtorë, të ndershëm dhe plot besim.

Burimi i privilegjuar, nga i cili Shen tja mori formimin e saj të krishterë, ishte katekizmi që së bashku me mësimet e familjes, kontribuoi për të vënë baza të forta mbi të cilët ajo, ku me kalimin e viteve, ndërtoi personalitetin e saj njerëzor dhe të krishterë.

Shtëpia, shkolla dhe Kisha ishin palestrat të cilat formuan karakterin e saj që nga fëmijëria ku i dhanë një orientim të përpiktë gjithë jetës së saj.

Kaloi gjithë rininë e saj, deri në moshën 30 (tridhjetë) vjeçare në gjirin e familjes së saj. U rrit e shëndetshme në shpirt dhe në trup, duke u dalluar gjithmonë për mirësi, e sinqertë dhe me përshpirtëri të spikatur. Që në moshë të re ishte bërë apostulle e moshatarëve të saj të cilët i formonte në virtyte me lexime të krishtera dhe mbi të gjitha me dëshminë e jetës së saj.

Shën Maria Domenica ishte 15 vjeçe kur i lumi Zef Nascimbeni arriti në Castelletto, para si mësues dhe si bashkëpunëtor i famullitarit (1877-1885) dhe më pas si famullitar (1885-1992). Që atëherë, ai bëhet udhëheqësi i saj shpirtëror i fortë e ndriçues, dhe ajo bëhet bashkëpunëtorja e parë bujare në aktivitetet e shumta të famullisë: ishte shpirti i rinisë i të gjithë vendit dhe ishte e dashur, e dëgjonin dhe e vlerësonin të gjithë bashkëfshatarët.

I dedikohej me shumë dëshirë mësimin të katekizmit të fëmijëve dhe mendohej me bamirësi ungjillore kundrejt vizitave dhe ndihmës për të varfërit dhe të sëmurët.

E rregjistruar në *Bashkimin e Përshpirtshëm të Bijave të Marisë*, ishte gjithmonë besnike në zbatimin e të gjitha përshkrimeve të Rregullores, duke u bërë pasqyrë dhe model për shoqet e saja, të cilat e vlerësonin shumë, ia dilte të jepte mësimet jete efikase.

Ishte plot me zell edhe në drejtimin e *Bashkimit të Përshpirtshëm të Nënave të Krishtera*, në angazhimin e përgatitjes së gruas për jetën e familjes dhe për detyrën e saj parësore të edukimit të fëmijëve.

Plotësisht e gjallëruar nga dashuria e Nënës së Hyjit dhe gjithmonë me besim të plotë në ndihmën e saj, më 08 dhjetor 1886 bën kushtin e perjetshëm të virgjërisë në duart e

drejtuesit dhe famullitarit të saj don Giuseppe Nascimbeni. Mbështetja në Virgjërën e Papërlyer që frymëmarrja e shpirtit të saj; intimiteti me Jezu Krishtin dhe soditja e Familjes së Shenjtë, forca e jetës së saj.

Me dëshirën për t'iu kushtuar Zotit, kupton planin e Hyjit mbi veten nëpërmjet të lumit Giuseppe Nascimbeni, i cili e deshi si bashkëpunëtoreshë të saj në themelimin e Kongregatës së Motrave të Vogla të Familjes së Shenjtë (06 nëntor 1892) u bë kështu Bashkëthemeluesja dhe eprorja e parë e Përgjithshme.

Në aktivitetet e famullisë, në udhëheqjen e Bijave të Marisë, në drejtimin e Nënave të krishtera dhe në qeverisjen e Institutit, nëna Maria Domenica Mantovani që një ndihmë e veçantë e Themeluesit, kundrejt të cilit mbeti gjithmonë e devotshme, interpretuese dhe zbatuese besnike e projekteve dhe e dëshirave të tij.

Ajo dha një kontribut thelbësor në përpunimin e Kushtetutës, e frymëzuar në rregullën e Urdhërit të Tretë Rregulltar të Shën Françeskut dhe në formimin e Motrave. Bashkëpunimi i saj, së bashku me dëshminë e një jete të përkryer, kontribuoi në mënyrë vendimtare në zhvillimin dhe në përhapjen e Institutit. Puna e saj shërbeu për të kompletuar atë të Themeluesit, duke vulosur në përshpirtërinë e Familjes rregulltare notat e veçanta që e kanë dalluar jetën dhe veprën në Kishë dhe në botë. Vepra e Themeluesit, në formimin e Motrave të para sipas karizmës së marrë nga Shpirti Shenjtë, gërshetohej me atë të Bashkëthemelueses dhe anasjelltas. Ajo e Nascimbeni-t ishte e dendur, e fortë, energjike, ajo e nënës Maria Domenica e fshehur, e butë dhe delikate, edhe pse e vendosur dhe pa dobësira. Ishte e vlerësuar nga shembujt efikas dhe nga pritje të durueshme.

Në shkrimet e Shenjtës dalin qartë në pah cilësitë e saja të një nëne të kujdesshme dhe të mirë, të një mësueseje të urtë dhe të ndritshme, të zellshme dhe nganjëherë kërkuese për të mirën e vërtetë.

Me vdekjen e Themeluesit ajo, e pasur me virtyte, me urti dhe përkujdesje të madhe, vazhdoi të udhëheqë Institutin me forcën e shpirtit, me braktisje të madhe në Hyjin dhe me ndienjë të thellë përgjegjësie, me dëshirën për t'iu transmetuar bijave mësimin e Themeluesit, me qëllim që shpirti i vërtetë i origjinës të ruhej dhe të jetohej plotësisht.

Para se të ndërronte jetë pati ngushëllimin të merrte aprovimin përfundimtar të Institutit dhe, *ad septennium*, të Kushtetutës (1932), por edhe të shihte veprën e vazhduar thuajse me 1200 motra, të pranishme në 150 shtëpi filiale, në Itali dhe në Vende të tjera, të angazhuara në shumë aktivitete apostolike dhe bamirësie.

Shën Maria Domenica, deri në fund të ditëve të saja, përparoi në rrugën e shenjtërisë, duke praktikuar të gjitha virtytet, në veçanti ata të përvujtërisë. Virgjëra Mari, gruaja e orës së fundit, të Cilës me shumë besim Shën Maria Domenica i drejtohej në lutjen e përditshme dhe të vazhdueshme duke përsëritur *tani e në fill e të vdekjes sonë* është bërë mbrojtëse e orës së fundit të saj, në festën e "Takimit", më 02 shkurt 1934, ia ka paraqitur Atit si një fli e pëlqyer, një sakrificë parfumi të këndshëm.

U shpall e Lume nga Shën Gjon Pali i II-të më 27 prill 2003